



Raporti Vjetor Annual Report

2009

Permbajtja

- I. Fjala e Hapjes e Drejtorit të Përgjithshëm
- II. Përmbushja e angazhimeve të marra në kuadër të MSA.
- III. Patentat dhe modelet e përdorimit
- IV. Markat tregtare dhe të shërbimit
Disenjt industrialë.
- V. Bordi i Apelit - Procedurat në Gjykatë
- VI. Marrëdhëniet me jashtë
- VII. Shërbimet e informacionit dhe baza e të dhënave
- VIII. Buletini i objekteve të PI
- IX- Faqja e internetit
- X. 26 Prilli – Dita ndërkombëtare e Pronësisë Intelektuale.
- XI. Trajnime, Aktivitete Kombëtare dhe Ndërkombetare.
- XII. Financa dhe Ekonomia

Contents

- I. Introduction Speech by General Director
- II. Achievement of the commitments in the framework of SAA.
- III. Patents and utility models
- IV. Trade and service marks
Industrial design
- V. Board of Appeal - Court procedures
- VI. International relation
- VII. Information services and IP database
- VIII. Industrial property objects bulletin
- IX. DGPT Web Site
- X. April 26, World Intellectual Property day
- XI. Training, National and International activities.
- XII. Finance and economy

I. FJALA E HAPJES E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM

I. INTRODUCTION SPEECH BY DIRECTOR GENERAL



Më lejon të shpreh kënaqësinë për t'ju paraqitur dokumentin më të rëndësishëm, që jep një vështrim të përgjithshëm, të saktë dhe informues mbi punën dhe arritjet e DPPM gjatë vitit 2009, Raportin Vjetor.

Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave, si një nga institucionet më të rëndësishme të sistemit të mbrojtjes së të drejtave të pronësisë industriale dhe institucioni i vetëm përgjegjës për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale në Shqipëri, ka si objektiv kryesor të tij, të sigurojë një nivel mbrojtjeje të njëjtë me atë të vendeve të BE në fushën e Pronësisë Industriale. Për arritjen e këtij objektivi, i cili është njëkohësisht edhe një nga angazhimet kryesore të marra përsipër në fushën e PI nga shteti shqiptar në dokumentat e partneritetit me BE, DPPM gjatë vitit 2009 ka përmbushur një sërë aktivitete zbatuese të cilat prezantohen në këtë raport.

Në progres raportin e BE të vitit 2008 thuhet se ka patur progres në fushën e mbrojtjes së të drejtave të Pronësisë Industriale por bashkëpunimi ndërinstitucional është me shumë rëndësi për progres të mëtejshëm. Ky rekomandim është marrë në konsideratë nga DPPM që gjatë vitit 2009 u vu në krye të iniciativës për hartimin e një Strategjie Kombëtare të Pronësisë Intelektuale, e cila do të bëjë të mundur rritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional ndërmjet institucioneve të përfshira në sistemin e mbrojtjes së Pronësisë Intelektuale dhe do të garantojë një mbrojtje efektive të këtyre të drejtave.

Gjatë vitit 2009, DPPM gjithashtu ka përmbushur me efektivitet detyrat që rrjedhin nga aktiviteti parësor i saj, që është regjistrimi i objekteve të pronësisë industriale. Stafi i DPPM ka punuar me përkushtim për përmirësimin e praktikave të procesimit të aplikimeve të paraqitura nga subjektet private shqiptare dhe të huaja, njëkohësisht

Please allow me the pleasure to present to you the most important document that gives a general informative and accurate overview over the tasks carried out and the achievements reached

by DGPT during 2009, the Annual Report.

Directorate General of Patents and Trademarks is one of the most important institutions in the system of enforcement of industrial property rights and the only institution responsible for the registration of industrial property objects in Albania, whose main goal is to ensure the same level of protection in the field of industrial property rights with that of EU countries. In order to reach that goal, which is at the same time one of the most important commitments made by the Albanian government in the documents of partnership with EU in the field of IP, DGPT during 2009 has taken several legal initiatives and implementing actions as will be presented following this report.

The progress report of EU for 2008 says that there has been progress in the field of IPR protection but better inter-institutional cooperation is needed for further progress. This recommendation is taken in consideration by DGPT which during 2009 initiated an inter-institutional action in order to prepare a National Strategy on Intellectual Property Rights which will serve the purpose of increasing the cooperation between the institutions involved in the system of IPR enforcement and will guarantee a more effective protection of these rights.

During 2009, DGPT has also fulfilled with efficiency the tasks concerning its primary activity that is the registration of industrial property objects. The DGPT staff has been committed to improve the practices of processing the applications submitted by Albanian and foreign applicants and at the same time to make a new configuration of these

duke i përshtatur këto praktika me parashikimet e ligjit të ri të pronësisë industriale dhe akteve nënligjore dalë në zbatim të tij, të cilat hynë në fuqi në fund të 2008 dhe fillim të 2009.

DPPM ka ndërmarrë një sërë aktivitete me qëllim promovimin e të drejtave të pronësisë industriale si: organizimi i seminareve me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të biznesit, në bashkëpunim me Dhomat e Tregtisë, publikimi i buletinëve të Pronësisë Industriale dhe i materialeve me karakter informues në faqen e internetit të DPPM, botimi i informacioneve promovuese në median e shkruar.

Krijimi i Bordit të Apelimit të DPPM, si një organ i brendshëm që shqyrton në rrugë administrative kërkesat për kundërshtimin e regjistrimit të objekteve të pronësisë industriale që shkelin të drejta të mëparshme dhe gjithashtu shërben si një organ i apelimit administrativ për vendimet e marra nga DPPM, përbën një hap të rëndësishëm në drejtim të forcimit të mbrojtjes së të drejtave të PI.

Viti 2009 ka qenë gjithashtu një vit i suksesshëm bashkëpunimi midis Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave dhe Markave dhe institucioneve ndërkombëtare si Zyra Europiane e Patentave (EPO) dhe Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale WIPO. Gjatë vitit 2009, DPPM në bashkëpunim të ngushtë me EPO arriti të finalizonte procedurat për ratifikimin nga parlamenti shqiptar të Konventës Evropiane të Patentave, si hapi final për antarësimin e Shqipërisë në Organizatën Evropiane të Patentave. Asistenca e dhënë nga EPO për DPPM ka konsistuar gjithashtu në dhënien e ekspertizës për përgatitjen e planit të veprimit për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Pronësinë Intelektuale. Seminare dhe aktivitete trajnuese për stafin e DPPM janë ofruar si nga EPO ashtu dhe WIPO.

Si përfundim mund të thuhet se janë përmbushur me sukses objektivat e vendosura për vitin 2009 në planin e veprimit të DPPM si dhe në planin kombëtar për zbatimin e MSA.

practices in conformity with the provisions of the new legislation and its implementing regulations which entered into force in the end of 2008 and the beginning of 2009.

DGPT has carried out several activities in order to promote industrial property rights such as the organization of seminars with the participation of representatives from the business groups in collaboration with the Chamber of Commerce, the publication of Industrial Property Bulletin and informative materials on the DGPT website and publication of promotional information in the printed media.

The establishment of the Board of Appeal, as an internal body of DGPT that examines, through administrative proceedings, the applications of opposition against the registration of IP objects that infringe previous rights and also serves as an administrative appeal body where the decisions of DGPT can be appealed, constitutes an important achievement toward the strengthening of IP rights protection.

During 2009 the collaboration between DGPT and international institutions such as European Patent Office (EPO) and World Intellectual Property Organization (WIPO) has reached new levels of success. DGPT in close collaboration with EPO achieved the finalization of the procedures for the ratification by the Albanian parliament of European Patent Convention, which was the final step in order for Albania to become a member state of European Patent Organization. EPO has also offered assistance to DGPT by giving expertise in establishing an action plan for the preparation of the National Strategy in the field of Intellectual Property. Seminars and training activities were offered for the staff of DGPT by both EPO and WIPO.

Finally it can be said that the objectives from the action plan of DGPT and the national plan for the Implementation of SAA for 2009 were successfully achieved.

II. PËRMBUSHJA E ANGAZHIMEVE TË MARRA NË KUADËR TË MSA

A. Iniciativa Ligjore

1. Aprovimi i akteve nënligjore në zbatim të ligjit “Për Pronësinë Industriale”.

Një ndër objektivat e DPPM për vitin 2009 në kuadër të përmbushjes së detyrimeve të parashikuara në Aneksin V të MSA-së ka qenë aprovimi dhe implementimi i akteve nënligjore në zbatim të ligjit Nr.9947 datë 07/07/2008. “Për Pronësinë Industriale”. Gjatë vitit 2009 janë miratuar dhe kanë hyrë në fuqi dy akte nënligjore në zbatim të Ligjit Nr.9947 datë 07/07/2008:

- VKM Nr. 381 dt. 08.04.2009 “Rregullore për Regjistrimin e Dizenjove Industriale”.

- VKM Nr. 883 datë 13.05.2009 “Për miratimin e tarifave për Regjistrimin e Objekteve të Pronësisë Industriale”.

Me urdhërin nr. 406, datë 06.05.2009 të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, u miratua Rregullorja e Brendshme e funksionimit të DPPM, e cila sjell si risi parashikimet lidhur me mënyrën e krijimit dhe funksionimit të Bordit të Apelit dhe mbi regjistrimin e përfaqësuesve të autorizuar të patentave dhe markave. Me hyrjen në fuqi të këtyre akteve nënligjore ka përfunduar edhe procesi i hartimit dhe miratimit të legjislacionit të ri në fushën e pronësisë industriale, i cili është plotësisht i përafëruar me legjislacionin e BE në këtë fushë.

2. Anëtarësimi në Marrëveshjet Ndërkombëtare

Neni 73 i MSA si dhe Aneksi V i kësaj marrëveshje parashikon detyrimin e shtetit shqiptar për t’u antarësuar në një numër marrëveshjesh ndërkombëtare në fushën e pronësisë industriale, brenda katër vjetëve nga hyrja në fuqi e MSA-së. Në zbatim të këtij detyrimi, gjatë vitit 2009,

II. ACHIEVEMENT OF THE COMMITMENTS IN THE FRAMEWORK OF SAA

A. Legal Initiatives

1. Approval of the implementing acts of Law “On Industrial Property”.

The approval of the implementing acts of Law No 9947 of 07.07.2008 “On Industrial Property” was one of the legal initiatives that had to be completed by DGPT in 2009 according to the provisions of the national plan for the implementation of SAA, Annex V of this agreement. In this context, two implementing acts were approved and entered into force in 2009:

- Decision of Council of Ministers No 381 dated 08.04.2009 “On the Approval of the Regulation concerning the Registration of Industrial Designs”.

- Decision of the Council of Ministers No 883 dated 13.05.2009 “On the Approval of Registration Fees for the Industrial Property Objects”.

Also the Internal Regulation of DGPT was approved with the Order of the Minister of Economy, Trade and Energy No 406 dated 06.05.2009. This regulation contains provisions about the procedures of creation and operation of the Board of Appeal and the procedures for the registration of the professional representatives of patents and trademarks. The entry into force of the above mentioned implementing act marks the finalization of the process of the preparation of the new legislation in the field of industrial property rights which is fully approximated with the EU legislation in this field.

2. Membership in International Agreements

Article 73 of SAA and Annex V of this agreement stipulate the obligation of Albania to access into several international agreements concerning Industrial Property Rights within 4 years from the entry into force of SAA. In order to comply with this obligation DGPT during 2009 has been

DPPM ka qenë në krye të iniciativës ligjore për aderimin e Shqipërisë në dy marrëveshjet e fundit ndërkombëtare në fushën e PI të parashikuara në listën e Aneksit V të MSA: Konventën Evropiane të Patentave dhe Marrëveshjen për të Drejtën e Patentave administruar nga WIPO, iniciativë e cila është finalizuar me aprovimin nga parlamenti shqiptar të ligjeve të mëposhtëm:

-Ligji Nr. 10179 datë 29.10.2009 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Evropiane të Patentave".

-Ligji Nr.10180 datë 29.10.2009 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Marrëveshjen për të drejtën e patentave të WIPO".

Ratifikimi i këtyre dy marrëveshjeve shënon dhe përfundimin e Iniciativave Ligjore të parashikuara në PKZMSA si dhe të Aneksit V të MSA-së.

Këto marrëveshje pritet të hyjnë në fuqi brenda muajit Prill 2010.

3. Hartimi i Strategjisë Kombëtare për Pronësinë Intelektuale

Një nga detyrat e MSA dhe një nga rekomandimet e Progress Raporteve të BE-së 2008, për vitin 2009 - 2010 është hartimi i Strategjisë Kombëtare për Pronësinë Intelektuale.

Në kuadër të zbatimit të këtij angazhimi, në Mars 2009 me mbështetjen e Ministrisë së Integritetit Europian, është ngritur një grup ndërmintor i përbashkët në përbërje të të cilit janë DPPM, ZSHDA, Doganat, Policia Tatimore, Drejtoria e Mbrotjtjes Konsumatore dhe Policia e Krimit Ekonomik.

Ky grup pune i krijuar me Urdhërin e Kryeministrit Nr. 40 dt. 18.03.2009 gjatë muajit Mars 2009 është mbledhur në takime të përbashkëta pune në mënyrë periodike nën kryesimin e Zv/Ministrit të Integritetit Europian.

Në kuadër të projektit IPA Rajonale 2007, DPPM ka kërkuar asistencë nga Zyra Evropiane e Patentave për kryerjen e një vlerësimi të sistemit të zbatimit të të drejtave të PI në Shqipëri, si hapi i parë për përgatitjen e një draft strategjisë.

the promoter of the legal initiative for the accession of Albania to the final two international agreements in the field of Industrial Property out of the list provided for by Annex V of SAA: European Patent Convention (EPC 200) and Patent Law Treaty (PLT) administered by WIPO. This legal initiative was finalized with the approval by the Albanian parliament of the following laws:

-Law No 10179 dated 29.10.2009 "On the Accession of the Republic of Albania to the European Patent Convention".

-Law No 10180 dated 29.10.2009 "On the Accession of the Republic of Albania to the Patent Law Treaty of WIPO".

The ratification of EPC 2000 and PLT constitutes the fulfillment of the legal initiatives provided for by Annex V of SAA and the National Plan for the Implementation of SAA. The above-mentioned agreements are expected to enter into force within April 2010.

3. The preparation of the National Strategy on Intellectual Property

The approval of a National Strategy on Intellectual Property is an obligation settled by SAA and also is highly recommend in the Progress Reports of EU for 2008.

In order to comply with this obligation, in March 2009 an inter-ministerial group was established under the care of the Ministry of Integration with representatives from the Directorate General of Patents and Trademarks, Albanian Office of Copyrights, Customs, Tax Police, Directorate for Consummators Protection and the Economic Crime Police.

This action group was established by the Order of the Prime Minister No 40 dated 18.03.2009. During March 2009, the action group for the preparation of the National Strategy of IP gathered in periodic sessions led by the Vice Minister of European Integration with the purpose of establishing the responsibilities of each institution involved in the IPR enforcement system. Also, in the framework of IPA Regional Program 2007, technical assistance was asked by DGPT and offered by EPO in order to have a complete assessment of the enforcement system of Intellectual Property Rights in Albania as a first step into preparing a draft strategy in this field.

Tre ekspertët e caktuar nga EPO zhvilluan në Maj dhe Nëntor të 2009 dy takime të rëndësishme me grupin e punës, rezultat i të cilëve ishte finalizimi i draft strategjisë. Draft Strategjia do t'i dërgohet për aprovim Këshillit të Ministrave dhe pritet të miratohet prej tij në fund të muajit Shtator 2010.

Three experts appointed by EPO met with the action group in two important group sessions in May and November 2009 and as a result the preparation of the draft strategy was finalized. The draft strategy will be sent for approval to the Council of Ministers and is expected to be approved by the end of September 2010.

B. Aktivitete zbatuese

B. Implementing Activities

1. Forcimi i kapaciteteve administrative të DPPM

1. Strengthening of the administrative capacities of DGPT

Në kuadër të Programit Rajonal IPA 2007, gjatë vitit 2009 u finalizuan fishat për aktivitetet e pritshme që do të financohen nga ky projekt dhe që kanë si qëllim forcimin e kapaciteteve administrative të DPPM si më poshtë:

In the framework of Regional Program IPA 2007, during 2009 DGPT has prepared the project fiches for the activities that are expected to be financed by this program with the scope of strengthening the administrative capacities of DGPT. These activities include:

- Përkthimi i Klasifikimit Ndërkombëtar të Patentave (IPC), trajnimi i stafit të Sektorit të Patentave lidhur me këtë klasifikim.
- Përkthimi i Klasifikimit të Locarnos mbi disenjot industriale dhe të edicionit të 9 të klasifikimit të Nicës për klasifikimin e mallrave dhe shërbimeve.
- Krijimi i një infrastrukture të sigurt të IT si dhe trajnime për këtë qëllim. Licensimi i ORACLE si dhe marrja e të dhënave bibliografike të patentave europiane në formë elektronike nga EPO.
- Hartimi i një plani veprues për shkëmbim informacioni ndërmjet DPPM dhe institucioneve të tjera që lidhen me Pronësinë Industriale duke bërë të mundur aksesimin on-line nga palët e treta në arkivën elektronike të objekteve të PI të DPPM.

- The translation of International Patent Classification (IPC) and training of the staff of the Patent Sector relating to the use of this classification.
- The translation of the Locarno Classification for the Industrial Designs and the 9th edition of the Nice Classification concerning the goods and services.
- Establishing a solid IT infrastructure and other relating activities such as training of the IT Sector's staff, the licensing of ORACLE and setting the necessary infrastructure for retrieving on-line the bibliographic data of European patents.
- The preparation of an action plan concerning the exchange of information between DGPT and other institutions involved in the IPR enforcement system by making the electronic archive of DGPT concerning the objects PI accessible on-line by third parties.

2. Pyetësori i Bashkimit European

2. EU Questionnaire

Në kuadër të integritimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin European si dhe depozitimit të kërkesës së Qeverisë Shqiptare për marrjen e statusit të vendit kandidat në muajin Dhjetor 2009 është dorëzuar Pyetësori i Komisionit European.

In the framework of the process of integration of the Republic of Albania to the European Union and the deposition of the request for obtaining the candidate status by the Albanian government, in December 2009 the pre-accession Questionnaire of the European Commission was handed to Albania by the EU delegation.

Në 11 Dhjetor 2009 është ngritur një Grup Pune i DPPM-së për përgatitjen e përgjigjeve të Kapitullit VII të pyetësorit i cili përmban pyetjet lidhur me Pronësisë Intelektuale. Grupi i punës së DPPM ka qenë pjesë e një grupi ndër-institucional pune i përbërë nga përfaqësues nga të gjitha institucionet përgjegjëse për mbrojtjen e të drejtave të PI. Grupi i punës është mbledhur në 6 raunde takimesh nën drejtimin Zv. Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, me qëllim koordinimin e informacionit të paraqitur nga secili institucion për Kapitullin VII të pyetësorit. Në fund të muajit Dhjetor 2009 është përfunduar drafti i përgjigjeve të pyetësorit i cili pritet t'i dorëzohet Komisionit Evropian brenda muajit Prill 2010.

In 11 December 2009 an action group was established within the DGPT for the preparation of the answers of Chapter VII of the EU Questionnaire concerning Intellectual Property Rights. The action group of DGPT was also part of an inter-institutional task group containing representatives from all the institutions involved in the system of IPT protection. The inter-institutional task group met in six different sessions under the leadership of the Vice Minister of Economy, Trade and Economy with the goal of coordinating the information inputted in the Chapter VII of the Questionnaire by each institution involved. In the end of December 2009 the action group finalized the draft answers of the Chapter VII of the EU Questionnaire which is expected to be delivered in April 2010.

III. PATENTAT DHE MODELET E PËRDORIMIT


III. PATENTS AND UTILITY MODELS

Në vitin 2009 numri i aplikimeve në total ka qenë 361 aplikime nga të cilat: 349 janë aplikime nga EPO dhe 12 janë aplikime në bazë të PCT. Gjatë vitit 2009 ka pasur 1 aplikim për model përdorimi.

In year 2009 the number of applications for patents in total was 361 from which 349 are European Patent Applications and 12 are PCT applications. During 2009 only 1 application for utility models was filed.

Tabela e mëposhtme tregon numrin e aplikimeve të depozituara pranë DPPM për lëshim patente, ndryshime në emrin/adresën e pronarit të patentës, ndryshimet e pronësisë së patentave, ripërtëritjet e patentave si dhe kërkesat për hetim si dhe numrin e dokumentave të lëshuara nga DPPM në lidhje me këto aplikime.

The following table shows the number of applications filed with DGPT concerning patent grants, changes in the name/address of patent owners, changes in the ownership of patents, patent renewals, patent searches and the number of documents issued by DGPT in respect of the said applications.




<i>Aplikime / Patenta</i> <i>Applications / Patents</i>	<i>Hyrje ne DPPM</i> <i>Entered in DGPT</i>	<i>Dalje nga DPPM</i> <i>Issued from DGPT</i>
<i>Aplikime për patentë</i> <i>Patent applications</i>	361	403 (grantime patentash granted patents)
<i>Ndryshim pronësie</i> <i>/ emri / adrese</i> <i>Change of ownership</i> <i>/ name / adress</i>	59	56 (te pranuar accepted)
<i>Aplikime për ripërtëritje</i> <i>/renewal patent applications</i>	1717	2136 (te pranuar accepted)
Hetim patente Patent search	176	175 (te pranuar accepted)

Gjatë vitit 2009 janë lëshuar 368 dëshmi depozitimi, 188 njoftime për plotësim formalitetesh nga të cilat 87 në fazën e ekzaminimit në file dhe 101 në ekzaminimin në formë të aplikimeve për patenta. DPPM ka lëshuar gjithashtu 21 njoftime refuzimi, nga të cilat: 3 janë refuzime për depozitimin e aplikimit, 17 janë refuzime për mosplotësim dokumentacioni në afatin e caktuar dhe 1 refuzim për mospagesë të tarifës së regjistrimit. Janë ekzaminuar dhe pranuar 2136 kërkesa për ripërtëritje patente. 320 patenta janë bërë të pavlefshme për shkak të mospagimit të tarifës vjetore të ripërtëritjes.

Grafiku i mëposhtëm tregon volumin e punës në krahasim me dy vite më parë


During 2009 the following documents were issued by DGPT: 368 filing certificates, 188 notifications to complete formalities, from which 87 notifications in receiving examination, and 101 notifications in the formal examination for patent applications. DGPT has also issued 21 refusal concerning patent applications of which 3 patent applications are refused during the receiving examination, 17 were refused for failure to complete the formalities within the legal time period, and 1 for failure of affecting the registration fee. 2136 patent renewals are examined and accepted, 320 patents became lapsed for failure of effecting of the annual renewal fee.

The table below shows the increase of the workload compared to two previous years.



Grafiku i mëposhtëm tregon statuset e aplikimeve për patenta që janë depozituar në vitin 2009.

The table below shows the status of patent applications that were filed in 2009.



Ndërsa grafiku i mëposhtëm tregon në përgjithësi gjendjen në aplikimet totale për Patenta. Siç tregon edhe grafiku i mëposhtëm ka mbetur vetëm 1% e aplikimeve pa u ekzaminuar por që janë brenda afateve ligjore në fuqi.

The table below shows the situation in general for total patent applications. As also shown in the following chart, only 1% of the applications have remained unexamined, but they are within the examination time limits according to the Patent Law and the Regulations.





Tabela dhe grafiku i mëposhtëm tregon numrin e aplikimeve për patenta dhe patentat e lëshuara në vitet 2000-2009.

The table and the graph below show the number of patent applications and patents granted in years 2000-2009.

Year	Patent applications	Patents issued in this year
2000	63	6
2001	120	49
2002	238	87
2003	392	201
2004	420	390
2005	386	395
2006	426	116
2007	367	420
2008	377	541
2009	361	402



Vlen të përmendet se në total numri i patentave të lëshuara në vitin 2009 përsëri është më i lartë se numri i aplikimeve. Ndërkohë që numri i aplikimeve për patenta për 2009 ka qenë 361 aplikime po gjatë këtij viti janë lëshuar 402 patenta.

Janë publikuar në buletin e Pronësisë Industriale: aplikimet për patenta së bashku me pretendimet, dorëheqjet, si edhe ndryshimet në pronësi, rivedosjet në afat si edhe korrigjimet e patentave.

Për herë të parë janë ekzaminuar kërkesat për amendamente në patentë si edhe janë ekzaminuar kërkesat për certifikata të mbrojtjes shtesë.

Gjithashtu për herë të parë janë shqyrtuar 22 raste për rivendosje në afat të patentave/aplikimeve për patente dhe janë kthyer në jetë 10 aplikime /patenta .

It is to be mentioned that the total number of patents issued in 2009 is higher than the number of the patent applications; hence the number of patent applications for 2009 was 361 and during the same year 402 patents were granted.

Patent applications together with their claims, withdrawn applications, recording of changes of patents ownership, granted requests for Re-establishment of rights, and the amendments made to patents are published in the Bulletins of Industrial Property issued by DGPT during 2009. Requests for patent amendments and Supplementary protection certificates are examined for the first time by DGPT.

Also requests for Re-establishment of rights for patents/patens applications were filed by applicants and examined for the first time by DGPT during 2009, of which 22 are examined and 10 of them are accepted.

IV. MARKAT TREGTARE DHE TË SHËRBIMIT, DISENJOT INDUSTRIALE

A. Markat Tregtare dhe të Shërbimit

Në vitin 2009 numri i aplikimeve për regjistrimin e markave ka arritur në 951 aplikime nga të cilat 301 janë aplikime për ripërtëritje marke. Gjithashtu, gjatë vitit 2009 janë lëshuar 962 certifikata regjistrimi marke nga të cilat 312 janë certifikata ripërtëritje marke.


IV. TRADE AND SERVICE MARKS, INDUSTRIAL DESIGNS

A. Trade and Service Marks

In the year 2009 the number of application for the registration of trademarks reached 951 applications. Also during 2009, 962 certificates were issued for the registration of marks, of which 312 were renewals.

Në grafikun e mëposhtëm paraqitet numri i aplikimeve, regjistrimeve dhe ripërtëritjeve për marka në Shqipëri gjatë viteve 1994-2009.

The following chart shows the number of applications, registrations and renewals for marks in Albania during the years 1994-2009.



Siç shihet nga grafiku numri i aplikimeve në vitin 2009 është pothuaj i njëjtë me numrin e aplikimeve në vitin 2008, ndërsa numri i regjistrimeve në vitin 2009 është më i lartë se numri i regjistrimeve në vitin 2008. Këtu duhet theksuar se numri i regjistrimeve në vitin 2009 është më i larti në 15 vitet e fundit duke përjashtuar këtu vitin 2006 ku është përballuar volum i madh pune e prapambetur.

As can be seen from the graph, the number of applications in year 2009 was almost the same with the number of applications in 2008, meanwhile the number of registrations in 2009 is greater than the number of registrations in 2008. It needs to be pointed out that the number of registrations in 2009 is the greatest of the last 15 years, except 2006 during which a large unperformed work from previous years has been recovered.

Gjatë vitit 2009 janë lëshuar: 643 dëshmi depozitimi të cilat janë publikuar; për 559 aplikime janë lëshuar njoftime për plotësim defektesh dhe formalitetesh, 445 ftesa për pagesë regjistrimi, janë ekzaminuar 143 aplikime për ndryshime ne pronësi dhe 260 ndryshime ne emër dhe adrese, janë lëshuar 650 çertifikata regjistrimi, 312 çertifikata regjistrimi ripërtëritje, dhe 1 dorëheqje nga marka.

During 2009, 643 certificates of filing were issued and published, for 559 of the applications, notifications to fix defects and complete formalities were sent, 445 requests for payment for registration were issued, 143 applications for change in ownership and 280 application for changes in name or address were examined, 650 certificates for registration and 312 certificates of registration renewal were issued and 1 withdrawn from marks is registered.

Gjithashtu gjatë këtij viti i është dhënë përgjigje 315 kërkesave për hetim marke, janë lëshuar 185 ekstrakte regjistri dhe 11 dublikata marke.


In addition, 315 trademark searches were performed, 185 extracts and 11 duplicates from the trademarks registered were issued.

Në total gjatë vitit 2009 janë lëshuar 3547 dokumenta për markat tregtare dhe të shërbimit, dizenjtat industriale dhe treguesit gjeografikë

During 2009, 3547 documents concerning trade and service marks, industrial design and geographical indication were issued.


Grafiku i mëposhtëm tregon një pjesë të dokumentave të lëshuara gjatë procesit të ekzaminimit gjatë vitit 2009.

The following graph shows a part of the documents issued during the process of examination of year 2009.



Në vitin 2009 janë lëshuar 650 certifikata regjistrimi marke nga 495 certifikata të lëshuara në vitin 2008 gjë që tregon se nga ana e DPPM-së është bërë një punë shumë e mirë në drejtim të ndërgjegjësimit të përfaqësuesve të autorizuar dhe subjekteve shqiptare në lidhje me mënyrën e paraqitjes dhe plotësimit të dokumentacionit. Plotësimi i saktë i dokumentacionit ndikon në eliminimin e lëshimit të njoftimeve për plotësim dokumentacioni, duke shpjetuar në këtë mënyrë procedurat për lëshimin e Çertifikatës së regjistrimit. Këtu ka ndikuar dhe faja e internetit të DPPM-së që përmban një informacion të plotë mbi dokumentacionin që duhet dorëzuar pranë DPPM.

During 2009, 650 registration certificates were issued compared to 495 certificates issued in 2008. This increase of the number of registration certificates is due to the good work performed by DGPT to raise the awareness of attorneys and Albanian subjects concerning the manner of representation and introduction of the documentation necessary for the registration of marks. The exact fulfillment of the applications documents influenced in the elimination of issuing notifications to fix defects and complete formalities and reduced the time limit for issuing the registration certificates. The process was helped by the web site of DGPT which included full information about the applications forms and the accompanying documentation that needs to be filed with the office.



Gjatë këtij viti është minimizuar koha për zbatimin e procedurave administrative për markat, duke zbatuar me rigozitet afatet ligjore.

During this year the time limit to fulfill the administrative procedures for marks has been minimized, by executing with correctness the legal procedure for registration of industrial property objects.

1. Aplikimet nga Marrëveshja e Madridit dhe aplikimet në rrugë kombëtare

1. Application from the Madrid Agreement and applications via national route.


Gjatë vitit 2009 janë depozituar 5337 aplikime dhe ripërtëritje nga të cilat 4386 nga Marrëveshja e Madridit, 738 aplikime të huaja (298 ripërtëritje) dhe 213 aplikime shqiptare.

During 2009, 5337 applications for trademarks registration and renewal were filed from which: 4386 applications through Madrid Agreement, 738 national applications from foreign applicants (from which 298 renewal applications) and 213 national applications from Albanian applicants.

Tabela dhe grafiku i mëposhtëm tregojnë numrin e aplikimeve vendase, aplikimeve në rrugë kombëtare dhe aplikimeve nga Marrëveshja e Madridit, gjatë vitit 2009.

The following tab and graph show the number of Albanian applications and foreign applications in national route and applications from Madrid Agreement during 2009.

Vitet Years	2009
Aplikime shqiptare Albanian application	213
Aplikime ne rruge kombëtare nga aplikante te huaj National application from foreing applicants	738
Aplikime nga Marrëveshja e Madridit/ Application from Madrid Agreement	4386
TOTALI TOTAL	5337



Në periudhën nga viti 1994 deri në vitin 2009 janë pranuar 50324 aplikime për marka nga të cilat 39080 aplikime nga Marrëveshja e Madridit dhe 11244 aplikime kombëtare dhe shqiptare.

Interesi në rritje i të huajve për mbrojtjen e markave të tyre në Shqipëri shprehet në numrin e lartë të aplikimeve dhe prezencën në rritje të mallrave të huaja në tregun shqiptar.

Tabela dhe grafiku i mëposhtëm paraqesin numrin e aplikimeve për marka në Shqipëri gjatë viteve 1994-2009.

In the period from 1994 to 2009, 50324 applications were accepted for marks, of which 39080 were applications from the Madrid Agreement and 11244 were applications through national route from foreign and Albanian applicants.


The growing interest of foreigners for the protection of their marks in Albania is expressed in the high number of applications and the growing presence of foreign goods in the Albanian market.

The following table shows the number of applications for marks in Albania during the period 1994-2009.

VITET YEARS	APLIKIME KOMBËTARE NATIONAL APPLICATION	APLIKIME SHQIPTARE ALBANIAN APPLICATION	APLIKIME NGA MARRËVESHJA E MADRIDIT APPLICATION FROM MADRID AGREEMENT	TOTALI SIPAS VITEVE TOTAL BY YEARS
1994-1995	1042	55	-	1097
1996	591	26	2064	2681
1997	572	36	2245	2853
1998	481	27	2344	2852
1999	502	17	2075	2594
2000	533	32	2223	2788
2001	696	54	2115	2865
2002	550	106	1814	2470
2003	451	132	1903	2486
2004	399	128	2252	2779
2005	825	147	2866	3838
2006	809	186	3624	4619
2007	744	148	4264	5156
2008	788	216	4905	5909
2009	738	213	4386	5337
Total sipas llojit të aplikimit Total by tipe of applications	9721	1523	39080	50324

Grafiku i mëposhtëm paraqet numrin e aplikimeve për marka në Shqipëri gjatë viteve 1994-2009.

The following chart shows the number of applications for marks in Albania during the years 1994-2009.



2. Aplikimet për marka sipas klasifikimit të Nicës për vitin 2009.

2. Applications for marks according to the Nice Classification for the year 2009.

Shqipëria është anëtare e Marrëveshjes së Nicës dhe për këtë qëllim është detyrim klasifikimi i mallrave dhe shërbimeve sipas këtij klasifikimi.


Pjesa më e madhe e markave të regjistruara janë në klasat 05, 35, 9, 3, 16, 30, 41, 32, 33, 29, 38 të klasifikimit të Nicës.

Albania is a member state of Nice Agreement concerning the classification of goods and services and it is obliged to classify goods and services according to this classification.

The majority of the registered trademarks claim protection in the following classes of Nice Classification: 05, 35, 09, 03, 16, 30, 41, 32, 33, 29 and 36.

Gjatë vitit 2009 prioritet ka patur mbrojtja e markave në sektorin farmaceutik, duke vazhduar me shërbimet në fushën e biznesit, menazhim biznesi, pajisjet elektronike, produktet ushqimore dhe me ingredientet e tyre si dhe me shërbimet për argëtim dhe aktivitete sportive dhe kulturore etj.

These data show the growing interest in the pharmaceutical sector, continuing with services for the management and administration of business, electronic equipments, foods products and their ingredients, as well as services for entertainment, sporting and cultural activities and etc.



3. Aplikimet dhe regjistrimet kombëtare për marka sipas qarqeve të vendit

3. National application and registration for marks according to the Albanian districts

Tabela e mëposhtme tregon aplikimet dhe regjistrimet kombëtare për marka të ndara sipas qarqeve të vendit. Siç shikohet Tirana e më pas Durrësi janë dy qytetet që kanë numrin më të madh të aplikimeve dhe regjistrimeve për marka, kjo për arsye se në këto qytete është përqendruar dhe pjesa më e madhe e popullsisë dhe biznesit.

The following table shows national applications and registration for marks divided according to the Albanian districts. As we can see Tirana and Durrës are the two cities with the largest number of applications and registrations for marks, because of the concentration of the major part of population and business in those areas.

QARKU/ DISTRICT	Aplikime per marka Application for marks	Marka te rregjistruara Registered marks
TIRANE	904	727
DURRES	119	97
ELBASAN	20	15
FIER	12	9
KUKES	0	0
GJIROKASTER	56	47
KORCE	39	32
VLORE	7	5
LEZHE	2	2
KAVAJE	1	1
SHKODER	20	15
MIRDITE	1	1
SARANDE	11	6
PERMET	2	1
KUCOVE	1	1
TEPELENE	4	2
LIBRAZHD	4	4
BALLSH	6	4


B. DISENJOT INDUSTRIALE

DPPM tashmë ka një bazë të dhënash të mirëfilltë për dizenjot industriale. Në vitin 2009 janë depozituar 4 kërkesa për regjistrim disenjoje dhe 1 kërkesë ripërtëritje disenjoje.

B. INDUSTRIAL DESIGNS

The DGPT now has a real data base for registration of industrial designs. In 2009 4 applications for registration and 1 application for renewal of industrial designs were filed.

Vitet	APLIKIME PER DIZENJO INDUSTRIALE	DIZENJO INDUSTRIALE TE LESHUARA
1995	1	0
1996	5	1
1997	15	3
1998	1	2
1999	0	9
2000	4	0
2001	6	9
2002	3	0
2003	45	6
2004	19	24
